



**KRYETARI I KOMUNËS**

Nr. 01-670/01-0021617/20 dt. 21.04.2026  
Mitrovicë

Bazuar në nenin 58, paragrafi 1, pikat: b dhe d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale, nenin 77, paragrafi 1, nënparagrafët: 1.2 dhe 1.4, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 5, të Rregullores Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë, si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005630-12/26, dt. 10.02.2026 Për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026; Kryetari i Komunës shpallë:

**KONKURS**

**Për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026**

1. SHPALLET Konkursi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026.
2. Në këtë konkurs do të ndahen 350 (treqind e pesëdhjetë) bursa për studentë në shumë mujore prej 80.00 € (tetëdhjetë euro), të cilat ipen për periudhën kohore nga 1 Tetori deri më 30 Qershor.
3. Nga numri i përgjithshëm i ndarjes se bursave, 10 bursa do u ipen studenteve nga komunitetet që jetojnë në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me këtë konkurs, respektivisht Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 për ndarjen e bursave për studentë.
4. Për realizimin e së drejtës në bursë, kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
  - 4.1 Kriteret e përgjithshme:
    - 4.1.1 Studentët/et, të kenë vendbanim të përhershëm në Mitrovicë;
    - 4.1.2 Përfitues të bursës studentore mund të jenë vetëm studentët e rregullt;
    - 4.1.3 Studentët që janë në marrëdhënie pune dhe që kanë të regjistruar Biznes Individual aktiv nuk mund të jenë përfitues të bursës;
    - 4.1.4 Studentët përfitues të bursës komunale nuk mund të jenë njëkohësisht edhe përfitues të ndonjë burse tjetër;
    - 4.1.5 Përfitues të bursës mund të jenë vetëm studentët e universiteteve publike;
    - 4.1.6 Studentët duhet të dëshmojnë gjendjen ekonomike sociale të familjes;
    - 4.1.7 Përfitues të bursës do të jenë kandidatët që do të mbledhin më së shumti pikë;
    - 4.1.8 Në rast të pikëve të njëjta përparësi do t'i ipet studentëve të Fakultetit Teknik, Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetit të Mjekësisë, apo studentit/es i cili është në vitin më të lartë të studimeve.
  - 4.2 Kriteret e veçanta:
    - 4.2.1 Përfitues me automatizëm të bursës do të jenë fëmijët, vëllezërit dhe motrat e dëshmorëve.
    - 4.2.2 Për suksesin e arritur në studime kandidati fiton këto pikë:
      - 4.2.2.1 Nota mesatare do të reflektohet si numër i pikëve shumëzuar me koeficientin.
      - 4.2.2.2 Studentët me notë mesatare 10.00 (dhjetë pikë zero zero) automatikisht janë përfitues të bursës.
    - 4.2.3 Për rastet si në vijim kandidatët do të vlerësohen me këto pikë:
      - 4.2.3.1 Kandidatët që në familjet e tyre kanë 2 (dy) e më shumë studentë të rregullt vlerësohen me 5 (pesë) pikë për secilin prej tyre.
      - 4.2.3.2 Fëmijët e invalidëve të luftës vlerësohen me 10 pikë;
      - 4.2.3.3 Fëmijët e veteranëve të luftës vlerësohen me 10 pikë;



- 4.2.3.4 Fëmijët e familjeve nën asistencë sociale vlerësohen me 10 pikë;
- 4.2.3.5 Fëmijët pa njërin prind vlerësohen me 10 pikë;
- 4.2.3.6 Fëmijët pa të dy prindërit vlerësohen me 15 pikë;
- 4.2.3.7 Studentët që kanë statusin e personave me aftësi të kufizuara vlerësohen me 20 pikë.

5. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni (merret dhe dorëzohet në Zyrën Pritëse);
- Vërtetimi se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2025/2026 (origjinale);
- Certifikata e notave (origjinale);
- Kopja e ID-së së studentit;
- Vërtetimi që studenti nuk është përfitues i bursës universitare;
- Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Vërtetimi se aplikuesi është anëtar i familjes së ngushtë të dëshmorit, invalidit dhe veteranit të UÇK-së apo të të rënit civil të luftës;
- Certifikata mbi gjendjen ekonomike (në emër të prindit); Gjendja ekonomike - financiare e familjes së kandidatit vërtetohet, sipas dëshmisë që lëshon Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë edhe rekomandimi nga Kryetari i Këshillit të fshatit/lagjes mbi gjendjen e pasurisë, por Komisioni ruan të drejtën të hulumtojë dhe vërtetojë gjendjen e vërtetë ekonomike-financiare të kandidatit.
- Vendimi mbi shfrytëzimin e ndihmës sociale.

6. Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

7. Vlerësimi i aplikacioneve bëhet nga Komisioni për ndarjen e bursave, i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës. Komisioni është i obliguar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti i mbylljes së këtij konkursi të vlerësoi aplikacionet, duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë konkurs dhe Rregulloren Komunale Nr. 02/2020.
8. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit, Komisioni do të hartojë listën përfundimtare të kandidatëve përfitues të bursës, listë e cila do të shpallet në ueb faqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve në Komunë.
9. Me studentët që fitojnë bursën, do të lidhet kontratë. Kontrata nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i bursës
10. Nëse brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e njoftimit të përftuesit të bursës nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit konsiderohet se studenti ka hequr dore nga bursa dhe përftues do të shpallet kandidati i cili është në listë sipas radhës.
11. Ne pajtim me Rregulloren Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për student, me kontratë do të përcaktohet kohëzgjatja për të cilën jepet bursa, obligimet e komunës, obligimet e përftuesit të bursës dhe kushtet e tjera.
12. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë studentët/et e rregullt, banorë të Komunës së Mitrovicës së Jugut pa dallim etnik, gjinor, racor, fetar dhe politik, që janë të regjistruar në ndonjë nga fakultet e universiteteve publike në Republikën e Kosovës, në përjashtim të studentëve të cilët kanë regjistruar vitin e parë akademik, studentëve të studimeve master dhe post-diplomike.
13. Ky konkurs zgjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit dhe shpallet në mjetet e informimit, në ueb faqe të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve në gjuhët zyrtare.



Kryetari i Komunës

Faton PEÇI